

# Refugee agencies help and advice



July 2007

Albanian

## Kredi Integrimi

**A ju është dhënë statusi i refugjatit ose mbrojtje humanitare duke nisur nga 11 Qershor 2007?** Nese pergjigja eshte po, ju jeni i përshtatshëm për një kredi qeveritare integrimi.

### Çfare është nje kredi integrimi?

Kreditë e integrimit janë kredi pa interes për t'i bërë të mundur refugjatëve dhe njerëzve të cilët kanë marrë mbrojtje humanitare të fillojnë jetën e tyre të re në MB. Ju lutem vini re që kjo është një kredi të cilët ju duhet ta shlyeni në të ardhmen.

### Për çfarë mund të përdoren ato?

Disa nga shembujt e gjërave për të cilat mund të keni nevojë për një kredi janë: depozita ne para për banimin; artikujt me të rëndësishmë për shtëpinë; karta udhëtimi për të mbërritur në intervista pune ose në punë; rroba ose mjete pune; arsimim dhe kualifikim. Ju mund të aplikoni për kredi për shpenzimet parësore jetese, nëse po trajtohemi apo studioni. Këto kredi nuk kanë për synim të mbulojnë shpenzime jo parësore.

### Kush mund të marrë një kredi integrimi?

Për të aplikuar për një kredi, ju duhet të jeni mbi 18 vjeç dhe të keni marrë statusin e refugjatit ose mbrojtje humanitare. Ju nuk mund të aplikoni për kredi më shumë se një herë. Nëse të dy, ti dhe bashkëshorti/ja juaj, jeni të përshtatshëm për të aplikuar për një kredi, ju mund të aplikoni sëbashku. Të dy bashkëshortët janë përgjegjës në mënyrë të barabartë për të paguar kredinë e përbashkët.

### Për çfarë shumash mund të aplikoni?

Sasia e kredisë do të llogaritet duke marrë parasysh nevojat dhe situatën tuaj specifike. Ajo mund të jetë nga £100 deri në £1000. Këto kredi janë të vlefshme si për aplikimet individuale ashtu edhe për ato të përbashkëtat.

Registered charity numbers: Refugee Action: 283660 Migrant Helpline: 1088631  
Scottish Refugee Council: SCO08639 Refugee Council: 1014576 Welsh Refugee Council: 1044885

Fletwpalosje tw tjera janw tw disponueshme nw <http://languages.refugeecouncil.org.uk>

Document control: Refugee Action, review date: December 2007



## Si do t'ju paguhet kredia?

Zakonisht kreditë do t'ju paguhen në një llogari bankare. Nëse nuk dispononi një llogari bankare dhe kredia juaj është nën vlerën £450, ju mund ta merrni atë me çek. Shuma nga ceku mund të tërhiqet vetëm në Zyrën Postare që e keni paracaktuar në aplikimin tuaj.

## Si do ta pagoni kredinë?

Shlyerja e kredisë zakonisht nisi pas gjashtë javës. Nëse jeni në punë, Departamenti i Punës dhe i Pensioneve (Department for Work and Pensions) do t'ju kontaktojë personalisht për të diskutuar për kredinë. Nëse ju merrni Ndhmë të Ardhurash (Income Support), Asistencë të Ardhurash për Punë-kërkuesit (Income-Based Jobseeker's Allowance) ose Kredite Pensioni, (Pension Credit), kështu e kredisë do të mbledhet direkt nga përfitimet tuaja. Norma e kesteve do të jetë shumë e ulët.

## A do të kem të drejtën që të aplikojë edhe për ndihma të tjera financiare?

Nëse kredia që keni marrë shërben për t'ju ndihmuar që të trajnoheni, të arsimoheni ose të punoni, duke përfshirë kështu shpenzimet për përkujdesjen e fëmijëve ose të jetesës, më parë ju duhet të diskutoni për këtë me zyrën tuaj të Qendrës së Punës Plus (Jobcentre Plus). Ndoshta për ju ka edhe mënyra të tjera për të gjetur mbështetje financiare falas që janë të disponueshme.

## Si të aplikoni për një kredi

Agjencia e Kufinjve dhe Emigracionit (Border and Immigration Agency) së bashku me letrën e vendimit që ju jep juve statusin e refugjatit ose mbrojtje humanitare duhet t'ju dërgojë gjithashtu edhe formularin e aplikimit për një kredi integrimi. Nëse nuk e keni marrë formularin, ju mund të merrni një të tillë duke telefonuar Skuadrën e Kredisë së Integrit (Integration Loan Team) në Agjencinë e Kufinjve dhe Emigracionit në numrin 020 8196 5440.

Agjencitë për Refugjatët, të tilla si Aksion për Refugjatët (Refugee Action), Linja Telefonike e Ndhmes për Emigrantët (Migrant Helpline), Këshilli Refugjatëve në Skoci (Scottish Refugee Council), Këshilli për Refugjatët (Refugee Council) dhe Këshilli Refugjatëve në Uells (Welsh Refugee Council) mund t'ju ndihmojnë që të plotësoni formularin e aplikimit. Organizata të tjera, të tilla si organizatat e komunitetit të refugjatëve apo të shërbimeve për Këshillimi të Qytetarit (Citizen's Advice) mund t'ju ndihmojnë gjithashtu.

## Këshilla lidhur me Paratë

Kini parasysh që ju duhet të shlyeni kredinë, prandaj është e rëndësishme që të merrni hua vetëm atë shumë të cilën jeni në gjendje ta shlyeni. Ju mund të keni të drejtën për të marrë fonde nga burime të tjera financiare të cilat nuk ju kërkojnë shlyerje të fondeve të marra. Ju lutemi që për diçka të tillë të flisni me agjencinë për refugjatët që ndodhet më pranë jush.